



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:255340
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05571565

PA1.nr.376/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Skender Çoçaj - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. D. , nga V, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrolle dhe posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjiilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan, PKR.nr.192/23, datë 10.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 05.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan PKR.nr.192/23, datë 10.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjiilan, me aktgjykimin, PKR.nr.192/23, datë 10.01.2024, të akuzuarin A. D. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrolle dhe posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1, të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) €, i cili dënim do te ekzekutohet ne afat prej 15 dite nga

dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Konfiskohen, një pushkë ajrore me dylbi, modeli EKOL Major ES450 me numër serik EM4-19030009 e kalibrit 4.5 mm, një pushkë të gjuetisë me dylbi me numër serik 88800 te kalibrit 12 mm, 21 copë fishek të kalibrit 7.64 mm, 10 copë fishekë të kalibrit 9 mm, një fishek te kalibrit 7.62 mm dhe 44 fishek te kalibrit 12/GA, dy gëzhoja te kalibrit 7.64 mm, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen nga Policia e Kosovës. Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) €, 50 (pesëdhjetë) €, në emër të viktimave të krimit si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën të e aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të lartë me gjobë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.384/24, të datës 12.03.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e prokurorisë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit të i shqiptohet dënim më i lartë me gjobë.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimin të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar që gjykata me rastin e peshimit të veprës penale dhe caktimit të dënimit ri rrethanë lehtësuese ka marr parasysh pranimin e fajësisë, pendimin, kërkim faljen, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprë të tillë e as tjera penale dhe se nuk është kryes i veprave tjera penale, duke i anashkaluar të gjitha rrethanat tjera rënduese e të cilat janë të shumta dhe atë rrezikshmëria shoqërore, duk qenë se i akuzuari në mënyrë të paautorizuar ka mbajtur sasi të madhe të municionit,

llojlojshmëria e municionit dhe e armëve, këmbëngulësia e të akuzuarit për të kryer veprën e tillë penale,, me vet faktin se i akuzuari këto armë i ka mbajtur në shtëpinë e vet. Me të drejtë themi se gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit nuk ka pasur për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në matjen e mirëfilltë të sanksionit penal edhe pse disa nga ato janë përmendur në arsyetimin e këtij aktgjykimi e që ato janë përmendur janë mbivlerësuar. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën të e aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të lartë me gjobë.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë, për shqiptimin e një dënimi më të lartë me gjobë, ndaj të akuzuarit, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të lartë me gjobë, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar konform dispozitave përkatëse ligjore, të KPRK-së, gjykata si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, ka pas parasysh pranimin e fajësisë, pendimin , kërkim faljen për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra te tilla dhe të tjera penale, nuk është i njohur si kryes i veprave penale. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e prokurorisë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarit të i shqiptoj dënim më të lartë me gjobë, sikurse që pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.376/24, më datë 05.04.2024

Zyrtarja ligjore;
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Zyhdi Haziri

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Skender Çoçaj